



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUIJË
(DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË TERRITORIT)

Nr. _____ Prot

Krujë , më ____ . ____ .2024

LENDA :Terma Reference per kontraten me objekt : “Mbikqyrja e punimeve te ndertimi të Bashkise Krujë- Faza e IV-te”, e ndare ne lote si vijon:

- **Loti i I:** (Mbikqyrja e punimeve per objektin , **Rijetezim i kalldremit mesjetar Krujë-Sarisalltik, Bashkia Krujë**)
- **Loti i II:** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin, “Sistemim-asfaltim i rrugës “Hoxhë Çela (rruga e Burgut), Fushë Krujë ”(Faza I).
- **Loti i III :** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin **Sistemim-asfaltim i rrugëve Ballaqevci e Xhamija dhe Sheshi Ambulances ,fshati Derven ,Nj.a. Thumane, Bashkia Krujë**”).
- **Loti i IV :** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin “Sistemim-asfaltim i rrugës “Katund Nuaj” (Faza II), Krujë”).
- **Loti i V :** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Hidri dhe Sejdini ,fshati Qereke Nj.a.Nikel” .
- **Loti i VI :** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin **Sistemim asfaltim I rrugës së “Shkollës”, fshati Borizanë, Nj.A.Thumanë, Kruje**).
- **Loti i VII :** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin **Rikualifikim Urban e shesheve të pallateve të shembura në territorin e Njësisë Administrative Fushë Krujë**).
- **Loti i VIII :** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin “Sistemim-asfaltim i rrugës së “Mashëve”, fshati Mazhe e Vogël, Nj.A.Bubq, Krujë”).

DREJTUAR : Personit Pergjegjes per Prokurimin Publik
Njesise se Prokurimit Publik

Ketu

Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën dhe të kryejë shërbimin e mbikqyrjes së punimeve në zbatim të Ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, **VKM nr.610 date 22.09.2022** ‘Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, udhezimit nr 3 date 15.02.2001 i KM ‘Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te zbatimit ne ndertim” i ndryshuar, VKM nr 354 datë 11.05.2016. “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim teritori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimit të Agjencisë së prokurimit Publik, “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM nr 354 datë 11.05.2016. “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim teritori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

TERMAT E REFERENCËS

‘MBIKQYRJA E PUNIMEVE PER OBJEKTET NDERTIMORE TE BASHKISE KRUIJE (FAZA E IV-te)’.

- **Loti i I:** (Mbikqyrja e punimeve per objektin, , **Rijetezim i kalldremit mesjetar Krujë-Sarisalltik, Bashkia Krujë**)
- **Loti i II:** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin, “**Sistemim-asfaltim i rrugës “Hoxhë Çela (rruga e Burgut), Fushë Krujë ”(Faza I).**
- **Loti i III :** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin **Sistemim-asfaltim i rrugëve Ballaqevci e Xhamija dhe Sheshi Ambulances ,fshati Derven ,Nj.a. Thumane, Bashkia Krujë**”).
- **Loti i IV :** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin “**Sistemim-asfaltim i rrugës “Katund Nuaj” (Faza II), Krujë**”).
- **Loti i V :** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin “**Sistemim-asfaltim i rrugëve “Hidri dhe Sejdini ,fshati Qereke Nj.a.Nikel”** .
- **Loti i VI :** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin **Sistemim asfaltim I rrugës së “Shkollës”, fshati Borizanë, Nj.A.Thumanë, Kruje).**
- **Loti i VII :** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin **Rikualifikim Urban e shesheve të pallateve të shembura në territorin e Njësisë Administrative Fushë Krujë**).
- **Loti i VIII :** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin “**Sistemim-asfaltim i rrugës së “Mashëve”, fshati Mazhe e Vogël, Nj.A.Bubq, Krujë**”).

1. Objektivi kryesor i Mbikqyresit

1.1-Mbikqyresi i punimeve te zbatimit te objektit ka per qellim te kontrolloje dhe te ndjeke mbarevajtjen e gjithe procesit te zbatimit te punimeve ne perputhje me projektin, kushtet teknike te zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor te percaktuar per kryerjen e punimeve ne perputhje te plote me rregullat e modalitetet e **VKM nr.610 date 22.09.2022** 'Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve''.

2. Detyrat, përgjegjesite dhe te drejtat e Mbikqyresit

2.1 Ne realizimin e objektivave per zbatimin e punimeve te projektit, Mbikqyresi menjehere mbas lidhjes se kontrates duhet:

- Te mbikqyre kontraten e zbatimit te punimeve ne emer te Autoritetit Kontraktor dhe te kryeje te gjitha detyrimet sipas kontrates se nenshkruar dhe legjislacionit ne fuqi.
- Te njihet ne detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike te objektit, te hartoje programin e kontrollit per zbatimin e projektit dhe cilesise se punimeve, si dhe zbatimin te VNM ne baze te standarteve te percaktuara me ligj (sipas Ligjit Nr. 8402, dt. 10.09.1998 dhe **VKM nr.610 date 22.09.2022** 'Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve'').
- Te paraqese prane Autoritetit Kontraktor stafin e tij mbikqyres, siç eshte percaktuar ne kerkesat e stafit kryesor.
- Ne baze te volumit te punimeve dhe vleres se kontrates Mbikqyresi i punimeve duhet te jete rezident me kohe pune te plote ne objekt, ndersa stafi tjetër mbikqyres mund te jete rezident ne objekt me kohe te pjesshme.

2.2 Mbikqyresi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Kontraktor, duke percaktuar detyrimet e ndersjellta, kushtet e punes, shperblimin, etj.

2.3 Mbikqyresi ve ne dijeni Autoritetin Kontraktor per nenkontraktoret e mundshem qe zgjedh Sipermaresi (Zbatuesi i Punimeve) ne perputhje me kontraten e zbatimit te punimeve.

2.4 Mbikqyresi ne fillim te punimeve ne objekt, merr kontakt me organet qeverisese, ne juridiksionin e te cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt, dhe informon personat kryesore përgjegjes per ndertimin e ketij objekti, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi (Neni 9, ligji Nr.8402, dt.10.09.1998 dhe **VKM nr.610 date 22.09.2022**).

3. Detyrat e mbikqyresit

3.1 Mbikqyresi ka per detyre:

- Te ndjeki me rigorozitet dhe te ushtroje detyren e tij ne perputhje me te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga **VKM nr.610 date 22.09.2022** 'Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve''
- Te kontrolloje vendosjen e tabelës se identifikimit te objektit me te dhenat e meposhtme:

- Emertimi i objektit:
- Investitori:
- Sipermarresi dhe drejtuesi teknik:
- Mbikqyresi:
- Afati i ndertimit te objektit:
- Vlera e objektit:

3.2 Mbikqyresi menjehere mbas lidhjes se kontrates duhet :

- Te marre masat e duhura per sigurine e objektit duke kontrolluar vendosjen ne objekt te tabelave perkatese sinjalizuese, treguese e te sigurise, shiritave, fenereve, etj.

- Mbas verifikimit te dokumentacionit duhet te dorezoje prane Autoritetit Kontraktor te gjitha dokumentacionin, si dhe shkresen per fillimin e punimeve ku te perfshihen:

- Stafi i Sipermarresit
- Makinerite qe do perdoren.

- Para fillimit te punimeve verifikon te gjitha pajisjet dhe makinerite e Sipermaresit, per te pare nese ato i pergjigjen kushteve te kontrates se zbatimit.

- Te kontrolloje zbatimin e projektit duke u bazuar ne projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe te propozoje modifikimet, plotesimet dhe mosperputhjet, nese ka, dhe ti propozoje Autoritetit Kontraktor zgjidhjet konkrete.

- Te ndjeke ne menyre te vazhdueshme e te kualifikuar te gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacione qe duhen te mbahen gjate zbatimit te punimeve.

- Te kontrolloje ne menyre korekte dhe te vazhdueshme piketimin e objektit dhe çdo material qe vendoset ne veper, menyren e vendosjes se tij dhe cilesine e tij.

- Per çdo punim te maskuar te beje (fotografimin ose regjistrim e tij dhe te mbaje procesverbal te firmosur prej tij dhe sipermaresit.

- Te kontrolloje çertifikatat e cilesise se materialeve dhe te jape miratimin per vendosjen e tyre ne objekt.

- Korrespondenca ndermjet paleve behet gjithnje ne menyre zyrtare, me shkrim.

4. Pergjegjesite e Mbikqyresit

4.1 Ne fillim te punimeve Mbikqyresi mban dhe ka pergjegjesi per dokumentacionin e meposstem:

- Projektin e firmosur nga investitori me specifikimet teknike.
- Dokumentacionin per realizimin e punimeve te objektit sipas projektit, kushteve teknike te zbatimit ne fuqi dhe specifikimeve teknike.
- Saktesine e vertetesine e dokumenteve, volumet dhe cilesine e punimeve.

- Per realizimin me korrektesi te kontrates se nenshkuar midis Sipermaresit dhe Autoritetit Kontraktor, per realizimin e te gjithë fazave te zbatimit te punimeve, respektimit te afatit te dorezimit.
- Asnje punim nuk do te mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikqyresit. Sipermaresi duhet te njoftoje Mbikqyresin kur eshte gati per t'u ekzaminuar prej tij.

5. Te drejtat e Mbikqyresit

5.1 Mbikqyresi ka te drejte:

- Te mos pranoje drejtues teknik, manovrator, punetor, etj, nqs keta nuk plotesojne kushtet per te kryer detyren e caktuar.
- Te pezulloje punimet kur sheh se ne objekt nuk jane marre masat e duhura per te siguruar punimet dhe trafikun.
- Te mos lejoje vendosjen ne veper te materialeve qe nuk plotesojne kushtet e cilesise.
- Te kerkoje per te gjitha makinerite qe punojne ne veper dokumentacionet teknike per te siguruar nje ecuri punimesh te sigurta dhe cilesore.
- Per çdo ndryshim te mundshem ne objekt, Mbikqyresi i punimeve ve ne dijeni Autoritetin Kontraktor.

5.2 Ky dokumentacion duhet te permbaje:

- Proçes-verbalin per fillimin e punimeve
- Projekt organizimin e punimeve
- Projektin teknik te zbatimit
- Grafikon e punimeve
- Specifikimet teknike
- Dokumentacionin fotografik apo video regjistruesi per punimet e padukshme
- Proçes-verbalet e çdo punimi te maskuar te firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyresi te shoqeruar me fotografi
- Çertifikatat e cilesise se materialeve
- Deklaraten teknike te Sipermarresit te firmosur nga Sipermarresi dhe drejtuesi teknik
- Njoftimin e sipermarresit per perfundimin e punimeve
- Proçes-verbalin e perfundimit te punimeve te firmosur nga Sipermarresi dhe Mbikqyresi.
- Relacionin perfundimtar te Mbikqyresit

5.3-Nje kopje e te gjithë dokumentacionit dorezohet sipas kerkesave te **VKM nr.610 date 22.09.2022** "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve"

6. Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes:

Afati i realizimit të supervizionit të punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit te punimeve nga sipermarresi i cili do të zbatojë punimet si dhe inspektimet gjatë periudhës së garancisë kur kërkohet nga investitori.

Shenim:Per cdo gje qe nuk eshte parashikuar ne keto terma , Mbikqyresit dhe Autoriteti Kontraktor duhet ti referohen **VKM nr.610 date 22.09.2022**’Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjesisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

Hartoi
Ing Ergys Sallaku